




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 035-174324 më 12.07.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L- 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 4, pika 1.1 dhe neneve 5, 10 dhe 14 të Ligjit nr. 04/L-110, për ndërtim, të datës 31.05.2012, dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110/391, të datës 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 12.07.2016, merr këtë

V E N D I M

P Ë R

ORGANIZIMIN DHE MASAT E SIGURISË NË VENDNDËRTIM

I

1. Bashkë me dokumentacionin teknik për aplikim, investitori apo pronari duhet ta prezantojë edhe elaboratin e organizimit të vendndërtimit.

II

1. Elaborati në fjalë, si në paragrafin I të këtij vendimi, nënkupton projektin e organizimit të vendndërtimit, pëlqimet përkatëse dhe masat që duhet të ndërmerren.

Ai duhet të përmbajë:

- 1.1. Rrethojën e vendndërtimit;
- 1.2. Përcaktimin e hyrje-daljeve të makinerisë dhe organizimin e rrugëve lëvizëse (brenda vendndërtimit) për makineri dhe personel, me prezantimin e shenjave sinjalizuese (horizontale dhe vertikale);
- 1.3. Projektin e sigurimit të gropës ndërtimore;
- 1.4. Objektet e përkohshme ndërtimore për punëtorë dhe personelin tjetër në vendndërtim dhe objektet për deponimin e materialit ndërtimor;
- 1.5. Vendosjen e vinçit-kranit, me përcaktimin e hapësirës manovruese;
- 1.6. Hapësirën e vendosjes së autopompës gjatë fazave të betonimit;

- 1.7. Kycjet e përkohshme në infrastrukturë, duke përfshirë (rrymën, ujësjellësin dhe kanalizimin);
- 1.8. Masat për largimin dhe trajtimin e ujërave nëntokësore, në rast të paraqitjes së tyre;
- 1.9. Organizimin e vendndërtimit jashtë parcelës;
- 1.10. Hapësirën për deponimin dhe menaxhimin e mbeturinave ndërtimore;
- 1.11. Hapësirën për vendosjen e fabrikës së betonit dhe agregatit;
- 1.12. Ndriçimin e vendndërtimit;
- 1.13. Hapësirën për pastrimin e automjeteve;
- 1.14. Projektin e skelave për punimin e fasadave dhe elementeve të tjera konstruktive në objekte;
- 1.15. Masat e nevojshme për parandalimin e rreziqeve në punë, bazuar në Ligjin nr. 04 L/161, për siguri dhe shëndetin në punë, të datës 16.05.2013.

III.

1. Elaborati nga pika I dhe paragrafi I i pikës II të këtij vendimi, do të hartohet nga kompania ose personi profesional.
2. Rrethoja nga pika 1.1 e paragrafit II, duhet të punohet në të gjithë perimetrin e vendndërtimit, brenda hapësirës së vendndërtimit, bazuar në incizimin gjeodezik, me kushte si më poshtë:
 - 2.1 Rrethoja të jetë jo transparente, me lartësi së paku 2 m, e punuar nga materiali rezistent ndaj goditjeve, kushteve atmosferike dhe të vendoset në konstruksionin stabil dhe të qëndrueshëm;
 - 2.2 Të vendoset me fillimin e punimeve dhe të largohet pas përfundimit të të gjitha punimeve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
 - 2.3 Të vendosen portat hyrëse, dalëse dhe tabela informuese;
 - 2.4 Tek terrenet në pjerrtësi, rrethoja duhet të vendoset e shkallëzuar, duke përcjellë rënien e terrenit, me lartësi së paku 2 m.
3. Hyrja dhe dalja nga vendndërtimi, përshkruar në paragrafin 1.3, pika II e këtij vendimi, organizohet përmes portave.
 - 3.1 Portat për hyrje dhe dalje të jenë me dimensione sipas standardeve, të mos pengojnë lëvizjen e lirë të kalimtarëve dhe kycjen e rregullt në komunikacion.
 - 3.2 Portat për hyrje dhe dalje mund të organizohen në një vend për hyrje dhe dalje, apo në vende të ndryshme, varësisht nga organizimi i brendshëm i vendpunishtes, apo edhe mundësia e kycjes në rrugë publike.

4. Projekti i sigurimit të gropës ndërtimore hartohet nga kompania apo personi profesional dhe i licencuar, bazuar në parametrat gjeomekanike dhe në harmoni me kodet strukturore për projektim- EUROCODE-t.
 - 4.1 Mënyra e sigurimit të gropës ndërtimore bëhet përmes pilotëve, diafragmave, pelankolave-hudërrasave, apo dhënies së formës përmes skarpateve, ku përzgjedhja e mënyrës do të bëhet nga kompania apo personi profesional dhe i licencuar.
5. Objektet e përkohshme nga paragrafi 1.4, pika II e këtij vendimi, përfshinë objektin e kontrollit, objektin e organit mbikëqyrës, objektet e punëtorëve, nyjat sanitare, objektet për deponimin e veglave dhe materialit ndërtimor etj.
 - 5.1 Objektet duhet të punohen nga materiali montues dhe demontues. Janë me karakter të përkohshëm dhe pas përfundimit të punimeve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare, largohen nga vendndërtimi.
 - 5.2 Objekti i portës hyrëse, i organit mbikëqyrës dhe objektet tjera në shërbim të punëtorëve dhe stafit, obligohen t'i përmbushin kushtet minimale tekniko-sanitare.
6. Në vendndërtim mund të parashihet vendosja e krani-vinçit.
 - 6.1 Pozita dhe rrezja e veprimit duhet të përcaktohet në atë mënyrë që mos të pengojë ndërtimin e objektit, të mos i rrezikojë objektet dhe personat në parcelat fqinje, si dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme për manovrim.
 - 6.2 Vendosja dhe montimi i kranit-vinçit duhet të bëhet nga ekipi profesional dhe i licencuar, i cili duhet ta ketë certifikatën e përdorimit.
7. Vendi për vendosjen e autopompës sipas paragrafit 1.6 të pikës II të këtij vendimi, përcaktohet brenda ose jashtë hapësirës së vendndërtimit.
 - 7.1 Në rastet kur vendosja e autopompës planifikohet të jetë jashtë vendndërtimit, në hapësirë publike, investitori - kryesi i punëve obligohet të pajiset me leje të veçantë nga organi kompetent.
 - 7.2 Në rastet kur vendosja e autopompës planifikohet të jetë jashtë vendndërtimit, në hapësirë private, investitori - kryesi i punëve obligohet të pajiset me pëlqim të vërtetuar nga pronari.
8. Në raste të paraqitjes së ujërave nëntokësore apo nga të reshurat atmosferike, investitori - kryesi i punëve obligohet që të bëjë largimin e tyre nga gropa ndërtimore, duke mos dëmtuar dhe ndotur hapësirën publike dhe private.

9. Në kuadër të vendndërtimit gjatë fazës së ndërtimit, rindërtimit, renovimit apo rrënimit të objektit, përcaktohet hapësira për vendosjen e kontejnerit për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve ndërtimore gjatë ditës. Kushtet tjera dhe trajtimin e tyre duhet ta bëjë në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 07/15, për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve.

9.1 Mjetet transportuese të marrin masat e sigurisë gjatë transportit të këtij materiali.

10. Në kuadër të vendndërtimit gjatë fazës së ndërtimit, rindërtimit apo renovimit të objektit, të planifikohet hapësira për vendosjen e skelave.

10.1 Vendosja e skelave të bëhet në kuadër të punishtes, të jenë stabile dhe të vendoset rrjeti me elementet mbrojtëse.

10.2 Në rastet kur skelat vendosen në hapësira publike të frekuentuara nga automjetet dhe kalimtarët, duhet të merren masa të sigurisë, në mënyrë që të mos pengojë qarkullimin e lirë të automjeteve dhe kalimtarëve, duke siguruar lejen nga organi kompetent.

11. Hapësira për vendosjen e fabrikës së betonit dhe agregatit nga paragrafi 1.11 i pikës II të këtij vendimi, nënkupton planifikimin e fabrikës për prodhimin e betonit dhe deponimin e agregatit. Prodhimi i betonit dhe deponimi i agregatit bëhet vetëm për nevojat e ndërtimit të objekteve në kuadër të vendndërtimit.

12. Hapësira për pastrimin e automjeteve nga paragrafi 1.13 i pikës II të këtij vendimi, nënkupton pastrimin e makinerisë, përkatësisht rrotave të automjeteve të personelit dhe mjeteve të tjera transportuese brenda vendpunishtes para daljes në trafik.

IV

1. Në hapësirat ku parashihet rrënimi i objekteve ekzistuese, me elaboratin e organizimit të vendndërtimit duhet të prezantohet edhe elaborati i rrënimit të objekteve.

1.1 Elaborati i rrënimit të objekteve duhet të hartohet nga kompani profesionale e licencuar dhe të përmbajë metodën e rrënimit të objekteve, masat e sigurisë gjatë rrënimit dhe masat për sigurinë e objekteve përreth.

1.2 Te objektet e ngjitura apo në varg, në rastet kur rrënohet vetëm një njësi, duhet të prezantohet analiza e stabilitetit të objekteve - njësive që mbeten pa u rrënuar.

V.

1. Organi kompetent gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik, sipas pikës I, me leje ndërtimore, miraton edhe elaboratin për organizim të vendndërtimit.
- 1.1 Pas miratimit të dokumentacionit teknik dhe elaboratit të organizimit të vendndërtimit, organi kompetent në fazën e trajtimit të dokumentacionit ndërtimor për leje ndërtimi, me vendim-pëlqim të veçantë mund të lejojë pronarin-investitorin që para pajisjes me leje ndërtimore, të bëjë organizimin e vendndërtimit sipas elaboratit të miratuar.
- 1.2 Organi kompetent në vendimin-pëlqimin bën përshkrimin e punëve të lejuara gjatë kësaj faze.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Inspektionit;
- Drejtorisë së Urbanizmit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

